



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Tiranë, më 21.01.2019

Nr. 3167/prot

Lënda:

Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës me propozimin e z. Bahri Shaqiri për t'u zgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 162 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19 pika 2, të ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", pas hapjes së procesit të aplikimeve dhe vlerësimit të kandidaturave të paraqitura, me Dekretin nr. 10929, datë 05.11.2018, i propozoi Kuvendit të Shqipërisë që zonja Vitore Tusha, të zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kuvendi i Shqipërisë, pasi shqyrtoi këtë propozim me Vendimin nr.126, datë 20.12.2018, ka vendosur: "Mosmiratimin e kandidaturës së zonjës Vitore Tusha dhe rrëzimin e dekretit nr. 10929, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit". Ky vendim është përcjellë nga Kuvendi në institucionin e Presidentit të Republikës, me shkresë nr.3553/2 prot, datë 24.12.2018.

Pas njohjes me Vendimin nr.126, datë 20.12.2018 të Kuvendit të Shqipërisë, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11063, datë 19.01.2019, ka vendosur që t'i propozojë Kuvendit të Shqipërisë që z. Bahri Shaqiri të zgjidhet në pozicionin Kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Zoti Bahri Shaqiri plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për t'u emëruar në këtë pozicion, si dhe është një kandidaturë me përvojë në drejtimin e institucioneve.

Gjatë përvojës 26-vjeçare të punës në institucionet e larta shtetërore, si: Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe aktualisht në Institucionin e Presidentit të Republikës, z. Bahri Shaqiri ka treguar integritet të lartë moral dhe profesional në ushtrimin me sukses të detyrave kaq të rëndësishme.

Zoti Shaqiri gjatë ushtrimit të detyrave të mësipërme ka patur bashkëpunim të shkëlqyer me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomiko-financiar.

Zoti Shaqiri ka njohuritë e duhura në fushën e ligjit dhe auditimit për të garantuar drejtimin profesional të këtij institucioni të pavarur.

Referuar sa më sipër, po Ju përcjellim dekretin e Presidentit të Republikës SH.T.Z. Ilir Meta, **nr.11063, datë 19.01.2019**, me të cilin i propozohet Kuvendin të Shqipërisë që Zotit Bahri Shaqiri të zgjidhet në funksionin kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga zoti Shaqiri, administruar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës me nr.3167 prot., datë 29.10.2018, kopje e njehsuar e së cilës është administruar dhe pranë Institucionit tonë.

Ju faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

